



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Konferenca e Kryetarëve

PROCESVERBAL

Tiranë, më 08.11.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Gramoz Ruçi – Kryetar i Kuvendit

Rendi i ditës:

1. Prezantimi në Konferencën e Kryetarëve i projektbuxhetit të vitit 2020, si dhe projektligjeve financiare që kanë lidhje me të nga ministrja e Financave, zonja Anila Denaj.

2. Miratimi i kalendarit të veçantë të projektbuxhetit dhe projektligjeve financiare që kanë lidhje me të.

3. Miratimi i kalendarit 3-javor të punimeve të Kuvendit për periudhën 25 nëntor-13 dhjetor 2019.

Të pranishëm:

Gramoz Ruçi – Kryetar i Kuvendit

Vasilika Hysi - Zëvendëskryetare e Kuvendit

Elisa Spiropali – Ministre për Marrëdhëniet me Parlamentin

Taulant Balla - Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste

Rudina Hajdari - Kryetare e Grupit Parlamentarë Demokrat/Kryetare e Komisionit për Integrimin European

Nimet Musaj - Kryetar i Grupit Parlamentar të Pavarur

Adriatik Alimadhi - Kryetar i Grupit Parlamentar të Partive të Djathta

Ulsi Manja - Kryetar i Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Mimi Kodheli - Kryetare e Komisionit për Politikën e Jashtme

Arben Ahmetaj - Kryetar i Komisionit të Ekonomisë dhe Financave

Enver Rroshi - Kryetare i Komisionit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë

Fatjona Dhimitri- Kryetare e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

Halil Jakim - Zëvendëskryetar i Komisionit për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Mungojnë:

Myslim Murizi - Zëvendëskryetar i Kuvendit

Ermonela Felaj - Kryetare e Komisionit për Sigurinë Kombëtare

Marrin pjesë:

Anila Denaj – Ministre e Financave dhe Ekonomisë

Mimoza Dhëmbi – Drejtore e Përgjithshme e Buxhetit

Niko Lera – Drejtor i Përgjithshëm i Politikave Fiskale dhe Makroekonomike

Endrit Lami – Drejtor i Politikave Makroekonomike

Merita Qato – Drejtore e Përgjithshme e Shërbimit Legjislativ

Mimoza Pano – Drejtore e Shërbimit të Seancës Plenare

Mimoza Arbi – Drejtore e Shërbimit Juridik

Lefteri Luzi – Drejtore e Shërbimit të Komisioneve

Alkida Llakaj – Drejtore e Shërbimit të Monitorimit të Institucioneve

HAPET MBLEDHJA

Gramoz Ruçi – A jeni gati?

E kam thirrur këtë mbledhje të Konferencës së Kryetarëve me rend dite prezantimin në Konferencë të projektbuxhetit për vitin 2020, si dhe projektligjeve financiare që kanë lidhje me të. Prezantimi, sipas traditës, do të bëhet nga ministrja e Financave, zonja Denaj. Mandej do të vazhdojmë me miratimin e kalendarit të veçantë për projektbuxhetin dhe projektligjet financiare që kanë lidhje me të. Më pas do të vazhdojmë me miratimin e kalendarit 3-javor për tri javët e ardhshme.

Siç e dini, projektbuxheti futet automatikisht në programin e punës së Kuvendit dhe sot do të miratojmë edhe kalendarin e veçantë për shqyrtimin e projektbuxhetit, si në parim, ashtu edhe nen për nen, të cilin e keni të gjithë përpara. Do ta diskutojmë pas paraqitjes.

Prandaj, në mbështetje të nenit 79, pika 2 e Rregullores, më lejoni t'ia jap fjalën ministres së Financave.

Po, zonja Anila.

Anila Denaj - I nderuar Kryetar i Kuvendit,

Të nderuar kryetarë të grupeve parlamentare dhe të komisioneve të Kuvendit,

Projektbuxheti 2020, që ju është vënë në dispozicion për shqyrtim, vijon të mbështesë reforma të rëndësishme të ndërmarra, që promovojnë rritjen ekonomike, punësimin, përmirësimin e cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarit dhe procesin e integritetit në Bashkimin Europian.

Projektbuxheti 2020 dhe ai afatmesëm 2020-2022, bazohen në një kuadër makroekonomik të kujdesshëm dhe realist. Politika makro-fiskale do të vijojë të orientohet drejt konsolidimit fiskal për të vijuar trajektoren rënësore të borxhit publik ndaj produktit të brendshëm bruto, premisë thelbësore kjo për të siguruar një rritje të lartë e të qëndrueshme të ekonomisë, rritje gjithëpërfshirëse të punësimit dhe konvergim të nivelit të të ardhurave drejt niveleve të synuara.

Rritja ekonomike parashikohet të jetë në nivelin 4,1% në vitin 2020 dhe 4,5% përgjatë viteve 2021-2022.

Premisat më kryesore mbi të cilat mbështetet ky parashikim janë themelet kryesore ekonomike, të cilat kanë vijuar të përmirësohen. Më lejoni të përmend disa prej tyre: përmirësimi i vijueshëm i tregut të punës; perceptimi pozitiv i aktorëve ekonomikë për të ardhmen e ekonomisë; konsolidimi fiskal dhe qëndrueshmëria e financave publike; stabiliteti

financiar dhe rritja e kreditimit të sektorit privat, si dhe qëndrueshmëria e pozicionit të jashtëm të ekonomisë.

Nga pikëpamja e kërkesës agregate pritet që rritja për periudhën afatmesme në vijim të gjenerohet kryesisht nga kërkesa e brendshme, si konsumi, ashtu edhe investimet. Edhe kërkesa e huaj neto parashikohet të japë një kontribut pozitiv, ndonëse në nivele më të moderuara se kontributi që do vijë nga kërkesa e brendshme.

Njëkohësisht, edhe objektivi tjetër i planifikuar në këtë buxhet, ai i sigurimit të një niveli të lartë të investimeve publike prej 4,5% të produktit të brendshëm bruto, do të jetë suportues për rritjen ekonomike dhe punësimin.

Rritja mbi 4%, e parashikuar për vitin 2020 do të përkthehet në më shumë punësim, ku synohet krijimi i rreth 35 mijë vende pune, si dhe një ulje e mëtejshme e shkallës së papunësisë poshtë nivelit aktual 11%.

Deficiti buxhetor për vitin 2020 parashikohet të jetë në nivelin 1,6% i produktit të brendshëm bruto. Ky përbën nivelin më të ulët të targetuar në dy dekadat e fundit.

Për të pestin vit radhazi balanca primare parashikohet të jetë pozitive, në nivelin 0,7%, duke synuar mbajtjen e borxhit në trajektoren rënëse.

Në fund të vitit 2020 borxhi publik pritet të ulet në nivelin e 62,2% të PBB-së, për të zbritur poshtë 60-përqindëshit të produktit të brendshëm bruto në 2021-shin dhe më tej në një trajektore rënëse në 57% në vitin 2022.

Më lejoni t'ju prezantoj shkurtimisht logjikën mbi të cilën janë bazuar pritshmëritë tona për rritjen ekonomike dhe vijueshmërinë e konsolidimit fiskal.

Ekonomia ka vijuar të regjistrojë rritje pozitive përgjatë gjysmës së parë të vitit 2019, përtej ngadalësimit, të cilin disa herë e kemi argumentuar në disa tryeza dhe në parlament. Shumë sektorë të ekonomisë kanë vijuar të kenë një rritje të konsiderueshme. Këto janë elementet bazë, të cilat mbështesin ekonominë në vijueshmëri.

Nga pikëpamja e kërkesës agregate, rritja në gjysmën e parë të vitit 2019 është gjeneruar kryesisht nga kërkesa e brendshme dhe specifikisht nga konsumi, si dhe, në njëfarë mase, edhe nga eksportet neto të shërbimeve, të cilat reflektojnë një performancë mjaft të mirë të turizmit edhe gjatë këtij viti.

Në gjysmën e parë të vitit 2019 konsumi final regjistroi një rritje reale prej 2,7%, duke vijuar të njëjtin trend pozitiv të periudhës së mëparshme. Pavarësisht rritjes së lartë prej më shumë se 10% të investimeve të huaja direkte në gjysmën e parë të vitit, krahasuar me vitin paraardhës, formimi i kapitalit fiks bruto (investimet në total) regjistroi një rritje më të moderuar për gjysmën e parë, duke reflektuar kryesisht zhvillimet e projektit TAP, i cili është në fazën përfundimtare të ndërtimit të tij.

Për sa i përket ofertës agregate, kontributi pozitiv i atribuohet pak a shumë të gjithë sektorëve, ku kryesori është ai i shërbimeve, veçanërisht tregtia, hoteleria dhe transporti, në reflektim edhe të performancës së turizmit, duke ndjekur më pas edhe ritmin e rritjes së sektorit të bujqësisë dhe atij të industrisë në përgjithësi.

Indeksi tremujor i ndjeshmërisë ekonomike ka ndjekur përgjithësisht një trend pozitiv gjatë tremujorëve të këtij viti kundrejt fundvitit të kaluar dhe qëndron konsiderueshëm mbi mesataren afatgjatë të tij.

Aktorët ekonomikë mbeten në tërësi optimistë për të ardhmen, premisë mjaft e rëndësishme kjo për të sjellë një vendimmarrje aktive për të investuar dhe konsumuar.

Më lejoni të përmend disa nga këta faktorë ekonomikë.

Stabiliteti financiar dhe përshpejtimi i kreditimit të ekonomisë.

Qëndrueshmëria e sektorit financiar, në terma të kapitalizmit, likuiditetit dhe përfitueshmërisë, vazhdon të mbetet një fundament tjetër i fortë dhe vijueshmëria e tij një element i rëndësishëm i zhvillimit ekonomik.

Pozicioni i jashtëm i ekonomisë dhe bilanci i pagesave mbetet mjaft i qëndrueshëm. Ka pasur një zgjerim të deficitit të llogarisë korrente për gjysmën e parë të këtij viti, duke reflektuar kryesisht importe më të larta të mallrave dhe një tkurrje të eksporteve, ku sërish energjia elektrike ka pasur ndikimin më të madh, si tek importet, ashtu edhe tek eksportet krahasuar me një vit më parë.

Megjithatë, nga ana tjetër, thellimi i deficitit tregtar gjatë gjysmës së parë të vitit është kompensuar në një masë të konsiderueshme nga rritja e suficitit të balancës së shërbimeve, ku reflektohet kryesisht performanca mjaft e mirë e shërbimeve të turizmit edhe gjatë këtij viti.

Në të njëjtën kohë, suficiti i llogarive financiare dhe kapitale u zgjerua me më shumë se dyfishin e zgjerimit të deficitit të llogarive korrente, kryesisht si pasojë e flukseve të larta të investimeve të huaja direkte, të cilat gjatë gjysmës së parë, sikurse e thashë, shënuan një rritje prej mbi 10% kundrejt gjysmës së parë të vitit 2018.

Për rrjedhojë, bilanci i përgjithshëm i pagesave dhe pozicioni i jashtëm i ekonomisë mbetet mjaft i qëndrueshëm, ku stoku i akumuluar i rezervave valutore qëndron në nivelet ekuivalente me mbi 6 muaj import mallrash e shërbimesh.

Qëndrueshmëria e financave publike dhe vijimi i konsolidimit fiskal është në vëmendje.

Së pari, konsolidimi fiskal ka dhënë efektet e tij edhe për vitin 2019, ku pritshmëria e deficitit buxhetor mbetet nën 2% nga 5% i PBB-së në vitin 2015. Niveli i deficitit buxhetor prej 1,6% i PBB-së, i targetuar për vitin 2020, është niveli më i ulët i targetuar më parë. Po e

përsëris, sepse ky është një element fundamental në raport me konsolidimin fiskal të financave publike.

Së dyti, konsolidimi fiskal është materializuar në një trajektore qartësisht rënëse të borxhit publik ndaj PBB-së. Vitet e fundit borxhi publik neto është reduktuar nga niveli më i lartë prej 71,9%, i regjistruar në vitin 2015, në rreth 64% i pritshëm për vitin 2019.

Rezultatet paraprake fiskale, deri në shtator të vitit 2019, tregojnë se realizimi i përgjithshëm i buxhetit mbetet plotësisht në përputhje me objektivat dhe parametrat kryesorë fiskalë.

Ka pasur një mungesë të të ardhurave prej rreth 2,2% në krahasim me planin e periudhës. Sidoqoftë, një mungesë e tillë e të ardhurave është absolutisht e absorbuar dhe e amortizuar nga hapësirat që janë në buxhetin fillestar.

Më lejoni të theksoj se rritja e të ardhurave nga një vit në tjetrin është në nivelin 3,4%.

Arritja e plotë e objektivave kryesore fiskale mbetet mjaft e sigurt.

Rrjedhimisht, bazuar në gjithë sa më sipër, vlerësojmë se ekzistojnë të gjitha premiset për një rritje ekonomike në fashën e 4-përqindëshit, si në vitin 2020, të marrë në konsideratë në këtë buxhet, ashtu edhe për periudhën afatmesme në vijim.

E vendosur në një perspektivë rajonale, rezulton se rritja ekonomike e Shqipërisë ka ndjekur një trajektore rritëse të qëndrueshme që prej vitit 2013, duke e tejkaluar mesataren e rajonit tre vjetët e fundit.

Parashikimi i të ardhurave për buxhetin e 2020, së pari, bazohet në një vlerësim realist për rezultatin e pritshëm të vitit 2019.

Të ardhurat totale të buxhetit të shtetit në fund të vitit 2019 priten të jenë rreth 474 miliardë lekë. Krahasuar me vitin 2018, rritja rezulton me +5,3% ose 24 miliardë lekë më shumë. Totali i të ardhurave të pritshme në raport me PBB-në në fund të këtij viti rezulton 27,8% nga 27,6 % në vitin 2018.

Rritja me 0,2 pikë përqindje ndaj produktit të brendshëm bruto e të gjitha të ardhurave të buxhetit të shtetit, është tregues i përmirësimit në mbledhjen e të ardhurave dhe luftës ndaj informalitetit, edhe pse këtu ka ende shumë punë për të bërë.

Së dyti, parashikimi i të ardhurave për 2020-ën, përveç zgjerimit natyral nga rritja e ekonomisë, faktorizon edhe përmirësimin e administrimit fiskal, nëpërmjet implementimit të projektit të fiskalizimit dhe minimizimin e informalitetit në ekonomi, si një objektiv kryesor i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Të ardhurat totale për vitin 2020 parashikohen me një rritje prej 6,2% mbi të ardhurat e pritshme të vitit 2019 ose 29,2 miliardë lekë më shumë.

Të ardhurat tatimore, që mbledhen nga administrata tatimore dhe ajo doganore, në vitin 2020 programohen të jenë rreth 334 miliardë lekë, me rritje 6,4 % ose rreth 20 miliardë lekë krahasuar me të pritshmin e vitit 2019.

Të ardhurat nga fondet speciale parashikohen të jenë 104 miliardë lekë, 4,6% më shumë se i pritshmi 2019 ose 4,7 miliardë lekë më shumë.

Të ardhurat e qeverisë vendore parashikohen në rreth 27 miliardë lekë ose me një ritëm rritjeje prej 5% kundrejt të pritshmit 2019. Më lejoni të theksoj se këto të ardhura, edhe këtë vit kanë treguar një ritëm pozitiv të rritjes së tyre.

Të ardhurat jotatimore parashikohen në rreth 21,5 miliardë lekë ose rreth 5,7% më shumë se i pritshmi i vitit 2019.

Në parashikimin e të ardhurave janë faktorizuar në mënyrë të ndërlidhur variablat makroekonomike me faktorët kryesorë, që ndikojnë në taksat specifike.

Elementet kryesore, që janë faktorizuar në parashikimin e të ardhurave, janë: rritja nominale e produktit të brendshëm bruto, duke analizuar këtë efekt në mënyrë të integruar me faktorë të tjerë për çdo taksë në veçanti, të ndërlidhur me të dhënat historike, si dhe me projeksionet e çmimeve në tregjet ndërkombëtare me impakt tek taksat, si tatimi mbi vlerën e shtuar, renta minerare dhe taksa doganore; kursi i pritshëm i këmbimit; sasitë e pritshme të importit të mallrave në përgjithësi dhe atyre me regjim akcize në veçanti, si dhe programimi i fondeve të nevojshme për rimbursimin e tatimpaguesve, me qëllim uljen e stokut në fund të vitit 2020 me rreth 67 % krahasuar me stokun e pritshëm në fundin e vitit 2019.

Për vitin 2020 nuk janë parashikuar ndryshime themelore fiskale. Prioritet do të jetë zbatimi dhe matja e efekteve të politikave fiskale të miratuara në 2-3 vjetët e fundit me qëllim konsolidimin e sistemit tatimor.

Ndryshimi kryesor ka të bëjë me ligjin e fiskalizimit, i cili pritet të ndikojë në transparencën dhe kontrollin e transaksioneve tregtare, nga ku gjenerohen detyrimet tatimore. Marrja në kohë reale e transaksioneve biznes-konsumator, si dhe me pas e atyre biznes-biznes nëpërmjet përdorimit të faturës elektronike, synon që brenda një periudhe 2-3 vjeçare të rrisë parametrat e TVSH-së së brendshme nga 8,8 % e në 9,1 % të saj, në raport me produktin e brendshëm bruto.

Gjithashtu, përmes ndryshimeve të bëra në legjislacionin fiskal synohet të ofrohen lehtësira fiskale edhe për sektorë në zhvillim të ekonomisë si ai i automobilitave, për të mundësuar tërheqjen e investimeve të huaja në këtë sektor, por dhe incentiva të tjera në aspektin social siç është edukimi dhe sporti.

Shpenzimet buxhetore të programuara për vitin 2020 janë rreth 532 miliardë lekë ose 29,7% e produktit të brendshëm bruto. Ato rriten me rreth 5,1% krahasuar me të pritshmin e

vitit 2019. Shpenzimet buxhetore për vitin 2020 do të vijojnë të mbështesin sektorët prioritarë, si: arsimi, shëndetësia, bujqësia, infrastruktura, të cilat janë të rëndësishme për të stimuluar rritjen potenciale të ekonomisë.

Për sa i takon arsimin, ky sektor prioritar do të marrë 3,3 miliardë lekë më shumë se buxheti i vitit 2019. Buxheti për Ministrinë e Arsimit është rritur me +9%.

Në këtë sektor do të financohen me përparësi:

Arsimi i lartë, duke rritur më shumë se dyfish investimet për arsimin, nga 340,5 milionë në vitin 2019, me mesatarisht 750 milionë lekë në vit përgjatë viteve 2020 – 2022. Me këtë buxhet garantohej mbështetje e vazhdueshme për studentët në kuadrin e Paktit për Universitetin;

ofrimi i teksteve shkollore falas për rreth 230-250 mijë nxënës të arsimit parauniversitar nga shtresat sociale në nevojë me një efekt prej 500 milionë lekë në vit;

për 1300-1400 nxënës të arsimit parauniversitar nga shtresat sociale në nevojë do të garantohej trajtimi me kuotë ushqimore.

Buxheti për shëndetësinë në vitin 2020 do të rritet me 2,75 miliardë lekë krahasuar me buxhetin e vitit 2019. Buxheti për Ministrinë e Shëndetësisë është rritur me +5%. Ky buxhet do të mbështesë:

rikonstruksionin e 120 qendrave shëndetësore për vitin 2020, me një vlerë prej 350 milionë lekësh. Këto qendra do të mobilohen dhe pajisen me pajisje mjekësore me një vlerë prej 64 milionë lekë për vitin 2020 dhe 30 milionë lekë për vitin 2021;

1000 pacientë më shumë çdo vit, përgjatë 2020-2022, do të përfitojnë nga skema e rimbursimit të ilaçeve;

uljen e nivelit aktual prej 15% të pacientëve të rishtuar për të njëjtën diagnozë brenda 72 orëve nëpërmjet urgjencës;

reduktimin e kohës aktuale prej 45 ditësh në listë pritjeje për ekzaminime të rëndësishme, si rezonancë magnetike, skaner e të tjera, uljen nën 5,3 për 1000 lindje të gjalla të indeksit aktual të vdekshmërisë foshnjore;

përmirësimin e mëtejshëm të koeficientit të shfrytëzimit të shtretërve me më shumë se 49% në krahasim me vitin 2019;

rritjen me më shumë e 45% të numrit të grave mbi 35 vjeç të depistuar për kancer gjiri.

Buxheti për bujqësinë në vitin 2020 do të rritet me 1,8 miliardë lekë më shumë krahasuar me buxhetin e vitit 2019, ose rreth 12% buxhet i shtuar. Në fushën e bujqësisë, përgjatë periudhës 2020-2022, synohet rritja e produktivitetit dhe konkurrueshmërisë së produkteve bujqësore dhe blegtorale, përmirësimi i standardeve dhe garantimi i sigurisë

ushqimore, si dhe zhvillimi i zonave rurale për një zhvillim bujqësor dhe rural të qëndrueshëm përmes nxitjes së shumëllojshmërisë së veprimtarive ekonomike në zonat rurale.

Shpenzimet kapitale (shpenzimet për investime publike) programohen me një rritje prej rreth 4% krahasuar me të pritshmin e këtij viti ose 4,7% në raport me produktin e brendshëm bruto. Ndërkohë, deficitin e këtij viti apo huamarrja vjetore neto, targetohet me vetëm 1,6% të produktit të brendshëm bruto. Balanca korrente fiskale për këtë vit programohet, gjithashtu, ndër nivelet më të larta të dy dekadave të fundit prej 3,1% të produktit të brendshëm bruto. Thënë ndryshe, në buxhetin e vitit 2020, për çdo 100 lekë të marra borxh, programohen 286 lekë investime publike, raport i cili vijon të ketë një përmirësim të ndjeshëm krahasuar me mesataren e këtij treguesi për periudhën 2014-2019, ku për çdo 100 lekë të marra borxh janë shpenzuar për investime publike 193 lekë.

Për sa i përket infrastrukturës rrugore për periudhën 2020-2022, synohet:

kompletimi i akseve rrugore nacionale si: Rruga e Arbrit; Milot – Balldren; dhe Orikum – Dukat, brenda vitit 2022;

kompletimi i pjesës dërrmuese të segmenteve rrugore në vazhdim me financim të brendshëm brenda vitit 2022, si: Kardhiq – Delvinë, Elbasan – Banjë, bajpas Shkodrës, bajpas Tepelenës, një pjesë e mirë e Unazës së Tiranës;

kompletimi i segmenteve rrugore brenda 2021 me financim të huaj si: bajpasi i Fierit, bajpasi i Vlorës, Qukës – Qafë Plloçë;

ulja e numrit të aksidenteve me pasojë humbje jetë njerëzish dhe numri i pikave të zeza me 25%.

Gjithashtu, në kuadër të zotimeve të marra edhe me partnerët tanë euro-atlantik, në fushën e sigurisë kombëtare do të rrisim buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes me rreth 2,8 miliardë lekë më shumë krahasuar me buxhetin e vitit 2019, për të garantuar objektivin e qeverisë që buxheti i mbrojtjes në vitin 2024 të jetë 2% e produktit të brendshëm bruto, angazhim i marrë në kuadër të anëtarësimit në NATO.

Ky buxhet, gjithashtu, plotëson të gjitha nevojat financiare të të gjitha institucioneve të reja të krijuara nga paketa e reformës në drejtësisë si, KLP-së, KLGJ-së, Byrosë së Hetimit, SPAK-u, duke përfshirë këtu edhe burimet e nevojshme financiare për pagat e rritura të magistratëve dhe oficerëve të Policisë Gjyqësore. Më lejoni të përmend që këto janë adresuar gjerësisht në projektbuxhetin e këtij viti me shtesa në buxhet në mënyrë të konsiderueshme. Sigurisht, kjo do të vijojë edhe në vitin pasardhës duke akomoduar plotësisht financimin për reformën në drejtësi.

Shpenzimet e personelit janë programuar në masën 83,5 miliardë lekë për vitin 2020, ku përveç financimit të plotë të kostos aktuale të administratës publike qendrore, faktorizohen,

gjithashtu, edhe efektet e plota të politikës së rritjes së pagave për sektorin e shëndetësisë, arsimit, mbrojtjes, sistemit penitenciar dhe punonjësit e përfaqësive diplomatike, të cilat u efektuan në 1 prill të vitit korrent.

Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes programohen në vlerën 50 miliardë lekë, duke prioritarizuar: mbështetjen e skemës së fermerëve, mirëmbajtjen e sistemeve të teknologjisë së informacionit në administratën publike, si dhe mirëmbajtjen e rrjetit rrugor kombëtar.

Shpenzimet për interesa parashikohen në nivelin 40,9 miliardë lekë ose 2,3% e produktit të brendshëm bruto, të cilat përfshijnë kontigjenca të mjaftueshme për të përballuar, edhe nëse do të kishte një rritje të normave të interesit, nga 1 deri në 2 pikë përqindjeje mbi nivelin aktual, edhe pse kjo nuk është e pritshme nga ne.

Subvencionet programohen në rreth 1,3 miliardë lekë. Këtu është favorizuar rialokimi i një pjese të mirë të subvencionit të parashikuar për ndërmarrjet e ujësjellës-kanalizime tek investimet publike për rehabilitimin dhe ndërtimin e rrjeteve të ujësjellës-kanalizimeve, në kuadër të përshpejtimin të reformës së ndërmarrë nga qeveria në këtë sektor.

Shpenzimet e fondeve speciale, që përfshijnë shpenzimet totale për fondin e sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe kompensimin në vlerë të ish-pronarëve, janë planifikuar në vlerën 188,6 miliardë lekë për vitin 2020.

Niveli i shpenzimeve për skemën e sigurimeve shoqërore për vitin 2020 parashikohet në vlerën e 137,5 miliardë lekë ose 7,7% e produktit të brendshëm bruto, raport thujtse i njëjtë me vitin 2019, nga e cila për indeksimin e pensioneve është parashikuar një fond prej 2,52 miliardë lekë.

Duhet theksuar se kjo skemë i rëndon tashmë më pak buxhetit të shtetit, krahasuar me 5-6 vjet më parë, si rezultat i rritjes së kontributeve dhe kryesisht i uljes së nivelit të informalitetit në tregun e punës dhe së dyti, rritjes së nivelit të punësimit në çdo sektor.

Në skemën e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2020 janë parashikuar rreth 44 miliardë lekë ose 2,5% e produktit të brendshëm bruto, nga rreth 42 miliardë lekë të parashikuara në fund të vitit 2019.

Fondi për kompensimin në vlerë të pronarëve parashikohet të jetë rreth 4,5 miliardë lekë nga rreth 1,9 miliardë lekë që ishte në vitin 2013. Është planifikuar në rritje nga vit në vit duke akumuluar në vitin 2022 5,5 miliardë lekë.

Rritja e fondit të kompensimit në vlerë të pronarëve bëhet në mbështetje të reformës së ndërmarrë nga qeveria për trajtimin e ish-pronarëve, pjesë e së cilës është kompensimi në vlerë për t'u realizuar brenda periudhës 10-vjeçare, të parashikuar dhe në ligjin nr.133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit”.

Shpenzime të tjera sociale janë programuar në masën 24, 6 miliardë lekë, që përfshijnë:

shpenzimet për pagesën e papunësisë në nivelin 600 milionë lekë;

shpenzimet për pagesën e ndihmës ekonomike dhe personave me aftësi të kufizuar në nivelin 21 miliardë lekë;

për ish-të përndjekurit është parashikuar një fond prej 1 miliard lekë;

për bonusin e lindjeve është parashikuar sërish një fond prej 2 miliardë lekësh, nga kjo politikë pritet të përfitojnë rreth 30 mijë familje gjatë vitit 2020

Niveli i fondit rezervë për vitin 2020 planifikohet në masën 1,7 miliardë lekë, përkatësisht 1,4 miliardë lekë fond rezervë i Këshillit të Ministrave dhe 300 milionë lekë fond kontigjence për financimin e reformës në sistemin e drejtësisë.

Investimet publike për vitin 2020 janë planifikuar në nivelin e 4,7% të produktit të brendshëm bruto ose rreth 84 miliardë lekë, me një rritje prej rreth 4% kundrejt të pritshmit të këtij viti.

Në planifikimin e investimeve për vitin 2020 janë mbajtur në konsideratë të gjitha detyrimet kontraktuale për projektet dhe investimet me financim të huaj dhe të brendshëm. Ashtu si edhe në vitin 2019, edhe në vitin 2020 do të ketë përparësi financimi i projekteve në vazhdim, duke synuar mbylljen e tyre brenda vitit 2021.

Buxheti i pushtetit vendor për vitin 2020 është programuar të jetë rreth 57 miliardë lekë, rreth 11,2 % më i lartë se ai i 2019-ës, ose rreth 5,7 miliardë lekë më shumë fonde për shërbime dhe investime publike vendore. Në raport me produktin e brendshëm bruto ky buxhet është rreth 3,2%.

Rritja e burimeve të buxhetit vendor në vitin 2020 krijon më shumë hapësira për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve për qytetarët (për funksionet ekzistuese dhe ato të reja të transferuara me reformën administrativo territoriale) dhe njëkohësisht për uljen e stokut të detyrimeve të prapambetura të trashëguara nga ndarja e vjetër administrativo territoriale.

Fokusi kryesor në buxhetin vendor të vitit 2020 për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë do të jetë konsolidimi i procesit të menaxhimit financiar në nivel vendor në funksion të vazhdimit të zbatimit të reformës administrativo territoriale dhe decentralizimit fiskal të njësisë së qeverisjes vendore.

Gjithashtu, përmes buxhetit të vitit 2020, do të vazhdojë mbështetja financiare për reformën në arsimin parashkollor me synim vendosjen e një skeme financimi të përshtatshme dhe efektive që synon përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimeve.

Duke e mbyllur, dëshiroj t'ju sjell në vëmendje objektivat madhorë që synon të realizojë qeveria nëpërmjet këtij projektbuxheti, sikurse është konsolidimi fiskal, si dhe forcimi e rritjes ekonomike të vendit.

Faleminderit për vëmendjen!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zonja Ministre!

Këtu përfundon prezantimi i projektbuxhetit, i cili filloi sot, por do të vazhdojë prezantimin fillimisht në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave dhe më pas në të gjitha komisionet deri në diskutimin në parim dhe më pas nen për nen, sipas kalendarit që do të miratojmë në pjesën e dytë.

Faleminderit medias për prezencën!

Do të vazhdojmë me pjesën tjetër të kalendarit, qoftë për diskutimin ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk ka sot.

Për pyetje do të keni kohë në komisione dhe në seancë. Sot bëhet thjesht prezantimi.

Gramoz Ruçi – Atëherë të vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës. Përpara keni një projektkalendar të Kuvendit “Për shqyrtimin dhe diskutimin e projektbuxhetit për vitin 2020”, përgatitur sipas Rregullores nga Komisioni i Ekonomisë. Siç e shikoni në projektkalendar janë parashikuar dy momentet ku përqendrohet Konferenca e Kryetarëve, së pari në data e shqyrtimit në parim dhe së dyti data e shqyrtimit nen për nen.

Siç e keni kalendarin para, për shqyrtimin në parim në projektkalendar është parashikuar data 2 dhjetor dhe për shqyrtimin nen për nen është parashikuar 12 dhjetori. Paraprakisht do të kërkoja që t'i ndryshojmë të dyja këto data, data 2, diskutimi në parim, të kalojë në datën 5, ditën e enjte, për t'u dhënë edhe më shumë kohë komisioneve, kurse data 12 të kalojë në datën 19, pra 5 ditë më vonë, me qëllim që komisionet dhe deputetët të kenë përsëri kohë të përgatiten. A ka ndonjë mendim ndryshe nga kolegët për këto dy ndryshime?

Po.

Vasilika Hysi – Shumë faleminderit, zoti Kryetar!

Në fakt, ne kemi miratuar një rezolutë në Kuvendin e Shqipërisë, ku është kërkuar që projektbuxheti të diskutohet edhe në këndvështrimin gjinor nga Nënkomisioni për Barazinë Gjinore dhe Aleanca e Grave Deputete.

Gramoz Ruçi – Vasilika, të lutem, lëri mos i ngatërro gjërat!

A ke gjë për kalendarin?

Vasilika Hysi – Për kalendarin po flas.

Gramoz Ruçi – Të gjitha komisionet e nënkomisionet të ulen e të diskutojnë. Po bëjmë kalendarin për to.

Vasilika Hysi – Te kalendari nuk është nënkomisioni.

Gramoz Ruçi – Komisionet dhe nënkomisionet kanë afat, ne po u shtojmë afatin, komisionet do të bëjnë programin e tyre. Në komisionin ku je ti dhe bën pjesë barazia gjinore të bëhet programi dhe të vendoset edhe Nënkomisioni.

Vasilika Hysi – Dakord. Enveri e ka parasysh.

(Diskutim pa mikrofon)

Gramoz Ruçi – Zonja Hajdari, ngritët dorën?

Ju lutem, edhe një herë, nuk bëjmë kalendar për nënkomisionet. Këtu Konferenca e Kryetarëve cakton datat dhe kohën që iu lihet në dispozicion komisioneve dhe nënkomisioneve. Komisionet dhe nënkomisionet do të bëjnë kalendarët e tyre. Mos i trazoni gjërat!

Urdhëro, zonja Hajdari!

Rudina Hajdari – Faleminderit, zoti Kryetar!

Kisha vetëm një propozim, sepse këtu thuhet që data e shqyrtimit të projektligjit është më 12 dhjetor, në fakt, kjo bie ndesh me agjendën time me një udhëtim në Amerikë që është caktuar nga Kuvendi, nuk është personal.

Gramoz Ruçi - Ju lutem, zonjë, më dëgjoni! Kini mendjen kur shtrohet problemi! A ka mundësi të më dëgjoni? Unë, kur bëra propozimet i kisha parasysh të gjitha, pra në kalendar është paraqitur data 2, unë e zhvendosa në datën 5, në projektkalendar është data 12, unë e zhvendosa në datën 19. A ka vërejtje të tjera? Nuk ka.

Ngelemi dakord me projektkalendarin.

E dyta, lidhur me problemet e barazisë gjinore, që shtroi zonja Hysi, e cila ka të drejtë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zonjë, edhe një herë, kryetarët e komisioneve janë këtu dhe do të mblidhen menjëherë dhe si punë të parë do të hartojnë kalendarin e veprimtarisë së komisionit përkatës dhe të nënkomisioneve. Prandaj ndiqeni detyrën!

E dyta, që kam me kalendarin, javën dedikuar zgjedhësve, që përkon me diskutimin në parim, nuk do ta zhvillojmë, pasi edhe në praktikë është që diskutohet buxheti në parim dhe nën për nën, edhe seancat zhvendosen, kështu që deputetët do të kushtojnë të gjithë veprimtarinë e tyre vetëm për diskutimin në komisione, prandaj të mos këtë asnjë mungesë.

A jemi dakord me datat dhe kalendarin?

Taulant Balla – Jo, një sekondë.

Pa dyshim që bie dakord me atë që thoni ju, që është praktikë e konsoliduar parlamentare që java e dedikuar punës me zgjedhësit, kur të diskutohet buxheti të mos jetë efektive. Por, duke qenë se në javën a parë të dhjetorit ne do të kemi dy seanca plenare...

Gramoz Ruçi – Për kalendarin për buxhetin, kurse për kalendarin për seancat e Kuvendit është pjesa e tretë.

A jeni dakord me pikën e dytë?

Miratohet.

U lutem, komisioneve të bëjnë programin e veprimtarisë së tyre!

Vazhdojmë me çështjen e tretë për projektkalendarin e paraqitur për periudhën 25 nëntor – 13 dhjetor 2019, që iu është vënë në dispozicion në rrugë elektronike, është parashikuar të zhvillohet në seancë në datën 27 nëntor në orën 10:00, ditën e mërkurë, pasi data 28 bie festë kombëtare, janë parashikuar 4 projektligje sipas rendit të ditës të parashikuar në draft-kalendar.

Në draft-kalendar data 12 dhjetor ora 10:00, e cila, siç ramë dakord u zhvendos në datën 19, pra atë ditë do të kemi edhe diskutimin nen për nen dhe në tërësi të projektbuxhetit dhe 5 projektligjet që i kemi sipas rendit të ditës. Në datën 5, kur do të jetë shqyrtimi në parim, do të diskutohet vetëm për projektbuxhetin, nuk do të ketë gjëra të tjera, por nëse do të kemi ndonjë emergjencë këtu jemi dhe e vendosim.

Tjetra që kam është se mund të zhvillohet një seancë e posaçme në datën 2 ose 3 dhjetor, por do t'ju njoftojmë, pasi mendohet se mund të vizitojë Shqipërinë Presidenti i PE-së, i cili do të mbajë dhe një fjalim në parlament. Megjithatë ende nuk është konfirmuar, por nëse do të konfirmohet, menjëherë, do t'ju njoftojmë, kështu që deputetët duhet të jenë të pranishëm atë ditë. Siç thamë në datën 5 do të jetë diskutimi i projektbuxhetit.

Pra, këto janë datat e diskutimit të projektligjeve në seancë.

A ka ndonjë vërejtje?

Po, zoti Balla.

Taulant Balla – Ajo që po thosha, dhe kërkoj ndjesë për ndërhyrjen, është se meqë do të kemi seancë si në datën 27 nëntor, ashtu dhe në 2-3 dhjetor dhe duke qenë se faza përgatitore, që përgatit seancën e datës 5 do të kërkojë që të ketë mbledhje komisionesh edhe në datat 26 dhe 27, ta linim në parim të dakordësuar mes anëtarëve të Konferencës së Kryetarëve, që në rast se do të fiksohet seanca e datës 3, për fjalimin e zotit Sasoli në seancë plenare, çështjet e rendit të ditës të datës 27 të përfshihen në seancën e datës 3. Kjo do të ishte më efektive edhe në funksion të jetës parlamentare për komisionet, por edhe për t'i dhënë një arsye më shumë efektivitetit të seancës së datës 3. Ta lëmë në parim të dakordësuar, se Kryetari i Kuvendit me të drejtë është në komunikim të drejtpërdrejtë me zotin Sasoli dhe praktikisht kanë rënë dakord me njëri-tjetrin për këtë vizitë të rëndësishme të Presidentit të PE-së. Por jemi të vetëdijshëm që mund të ndodhë diçka e paparashikuar me agjendat e paparashikuara të njërit

apo tjetrit dhe mund të shtyhet, por ta lëmë në parim të dakordësuar që çështjet e rendit të ditës 27-a të zhvillohen në datën 3.

Gramoz Ruçi – Po.

Arben Ahmetaj – Kam dy komente, një për programin dhe një për buxhetin, se thashë t’i përmbledhja të dyja në një moment.

Kemi ligjin “Për censusin”, i cili nuk na është konfirmuar nga KM-ja për të ecur me të. Nëse e gjykoni, mund ta nxjerrim nga programi derisa të kemi një konfirmim të kuadrimin të plotë të çështjeve që ka brenda atij ligji nga KM-ja.

Gramoz Ruçi – Cili projektligj është ky?

Arben Ahmetaj – Për censusin.

Ku është Moza, se nuk e shoh? Sqarojeni Kryetarin në një moment të dytë! Të mos ta mbajmë në program, nëse e gjykoni.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ta e heqim nga kalendari dhe ta lëmë në program, pastaj e di vetë Kryetari se kur e fut sërish pasi të marrim konfirmimin.

E dyta, për sa i përket procedurës së buxhetit, në fjalën e ministres, që është zyrtare, ju referuat të pritshmit për çdo gjë dhe jemi sot gati mesi i nëntorit, por unë i dua zyrtarisht të gjitha shifrat e pritshme dhe jo mesatare, por dua të 18-ës dhe 19-ës, për të gjitha shifrat që referohet, pra të pritshmet e të ardhurave, të pritshmet e shpenzimeve në detaje, në mënyrë që të gjykoj nëse 6,2 përqindëshi apo 4,1 përqindëshi i PBB-së, por ky nuk është diskutim teknik, por procedural dhe logjistik, bëjnë sens për komisionin dhe qytetarët që do ta dëgjojnë. Kjo është shumë e rëndësishme, sepse duhet të fillojmë të krahasojmë vitet, të pritshmin, efektivitetin e administrimit fiskal, pastaj të gjykojmë për të ardhurat për vitin tjetër.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Po.

Ulsi Manja – Meqenëse jemi në vazhdim të asaj që tha kolegu Ahmetaj, unë do të kërkoja të bëheshin pjesë e programit të punës së Kuvendit edhe 3 projektligje, ku Komisioni i Ligjeve të përfshihet si komision për dhënie mendimi e më pas të bëhemi edhe pjesë e kalendarit 3-javor të punimeve të Kuvendit, sepse, në vlerësimin tim, këto 3 projektligje duhet të kalojnë patjetër në komisionin tim, si komision për dhënie mendimi gjithmonë. E kam fjalën për projektligjin “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, që është pjesë paketës së ligjit “Për antishpifjen”. Ne jemi komision për dhënie mendimi për projektligjin e AMA-s, por bashkë me këtë projektligj ne do të duhet të jemi komision për dhënie mendimi se është pjesë e së njëjtës paketë.

E dyta është projektligji “Për shtetësinë”, i cili duhet të kalojë patjetër në Komisionin e Ligjeve, për ta parë këtë projektligj nga pikëpamja kushtetuese dhe e kuadrit ligjor në Republikën e Shqipërisë.

Projektligji i tretë është “Për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare” dhe duhet patjetër që ne të jemi komision për dhënie mendimi, pasi ka të bëjë me mbrojtjen e të dhënave personale dhe lidhet drejtpërsëdrejti me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Ne kemi rënë dakord me shërbimet e Kuvendit që këto tri projektligje të përfshihen në program që ne të jemi komision për dhënie mendimi.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Zonja Hajdari.

Rudina Hajdari – Edhe unë kam dy pika, e para, në lidhje me propozimin e zotit Manja, është mirë që aktivitetet të ndahen mes komisionit tuaj dhe Komisionit të Medies, kështu që nuk ka nevojë t’i bëjmë bashkarish me idenë që këto komisione udhëhiqen nga maxhoranca dhe opozita. Ne kemi rolin tonë kontrollues për këtë projektligj dhe patjetër që do ta shohim me detaje. Ndoshta do të kërkoja që ky projektligj të kalonte edhe në Komisionin e Integritetit për dhënie mendimi, për shkak se ne duhet ta përditësojmë në një lloj mënyrë që të kemi përputhje edhe me legjislacionin e BE-së në këtë drejtim.

Çështja tjetër që dua të ngre, ndoshta zonja kryetare e Komisionit të Edukimit mund të ketë një koment në lidhje me këtë, është se do të doja të propozoja të kishim në shqyrtim edhe një ligj për amnistinë, që ne nuk e kemi prekur fare këto dy vitet e fundit. Më kanë ardhur shumë letra, në fakt, duhet të jetë pak strikte, unë e kuptoj situatën ku jemi, megjithatë duhet ta marrim në konsideratë, se janë disa vite që nuk e shqyrtojmë në parlament. Jemi në prag të festave dhe mund ta fusim në kalendar për të parë para festave.

Këto ishin dy propozimet.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Po.

Fatjona Dhimitri – Faleminderit, zoti Kryetar!

Meqenëse kam përballë kryetarin e Komisionit të Ligjeve, zotin Manja, në lidhje me projektligjin “Për mediet audiovizive në Republikën e Shqipërisë” nga ana e Komisionit të Ligjeve më është diktuar mënyra e punës përmes datave në Komisionin e Edukimit.

Zoti Manja, unë e refuzoj këtë lloj marrëveshjeje të presupozuar nga komisioni juaj. Mbledhjet në komisione dhe sidomos dëgjuesat do të bëhen të ndara, gjithmonë duke u bazuar, apo dëgjuar në mendimet e aktorëve të interesit. Ju kërkoni që ditën e hënë, sipas draftit të kalendarit të propozuar nga ana juaj, ne të kemi një mbledhje të përbashkët, ku ju do të bëni

edhe publikimin e draftit final, ndërkohë që drafti është në errësirë, zoti kryetar. Unë nuk e kam draftin e propozuar nga Komisioni i Ligjeve.

Gramoz Ruçi - Çfarë ka?

Fatjona Dhimitri – Më është propozuar nga ana e Komisionit të Ligjeve...

Gramoz Ruçi – Se të propozoi çfarë u bë?

Fatjona Dhimitri – Nuk ka pse të bëjmë mbledhje të përbashkëta për të realizuar dëgjesa të tilla kur deputetët apo përfaqësuesit e Komisionit të Edukimit nuk kanë draftin final, zoti Kryetar.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – A ka tjetër?

Po.

Vasilika Hysi - Faleminderit, zoti Kryetar!

Unë pajtohem me sugjerimet që bëri kryetari i Komisionit të Ligjeve për ligjet “Për komunikimet elektronike”, “Për shtetësinë”, si dhe “Për transferimin e të dhënave”.

Në lidhje me shqetësimin që ngre zonja Dhimitri, është e drejtë e komisioneve të vendosin nëse do të zhvillojnë komisione të përbashkëta ose jo. Është një sugjerim që bën kryetari i komisionit, unë jam bashkërelatore për këto projektligje. Ne i shikojmë nga këndvështrimi i të drejtës kushtetuese, i të drejtave të njeriut, si dhe në harmonizim me ligjet e tjera. Ju e shikoni në aspektin e ligjin “Për mediet”, por është praktikë në Kuvendin e Shqipërisë që të mos vijnë të njëjtët persona, palë disa herë në seancë dëgjimore. Seanca dëgjimore bëhet e përbashkët, ku secili komision bën pyetje brenda fushës së juridiksionit të tij. Komisioni i Ligjeve do t’i thërrasë në seancë dëgjimore, sepse ne jemi komisioni që do t’i shikojnë në tri aspekte: në kushtetutshmëri, të drejtat e njeriut dhe harmonizim me ligjet e tjera. Ju do t’i thërrisni si komision përgjegjës për njërin, apo zoti Peleshi për ligjin tjetër. Do të ishte shumë e rënduar për palët që të vinin njëherë në Komisionin e Ligjeve dhe brenda javës të vinin në komisionin tuaj. Në praktikën, të paktën prej 11 vjetësh që jam deputete në Kuvendin e Shqipërisë, ne kemi gjetur si zgjidhje, që secili bën pyetje. Mbledhjet pastaj vazhdojnë të ndara në këndvështrimin dhe brenda fushës së veprimit të secilit komision. Besoj se do të ishte më me vlerë, sepse të gjithë anëtarët e komisioneve do të përfitonin nga pyetjet, përgjigjet, por edhe relatorët përkatës do të përfitonin nga pyetjet që do të bënin anëtarët e Komisionit të Medies apo të Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese.

Gramoz Ruçi - Po, zoti Manja.

Ulsi Manja - Lidhur me këtë problem që ngre Komisioni i Medies, ne jemi dy komisione të përhershme të të njëjtit parlament dhe përtej praktikës parlamentare të konsoliduar tashmë në Kuvendin e Shqipërisë, për të cilën foli kolegja Hysi, i kam bërë një

propozim komisionit përgjegjës, jam dakordësuar edhe me zotin Peleshi që është komision për dhënie mendimi i njërit prej projektligjeve, sepse dy projektligjet janë paketë, që gjithmonë për efekt të eficiencës së punës së komisioneve të zhvillonim seanca dëgjimore të përbashkëta me grupet e interesit, por në asnjë rast asnjëri nga komisionet, qoftë ne për dhënie mendimi, qoftë komisioni përgjegjës nuk mund t'i diktojmë punën njëri-tjetrit. Gjithsesi, unë sot pasi ky projektligj do të vendoset nga Konferenca e Kryetarëve të jetë pjesë e programit të punës dhe do të përfshihet edhe Komisioni i Ligjeve për dhënie mendimi, kam bërë gati kalendarin e punës së Komisionit të Ligjeve dhe të dy këto projektligje në formë pakete do t'i kalojmë si komision për dhënie mendimi dhe do të zhvillojmë edhe seancat dëgjimore nëse do ta çmojë komisioni. Më pas do t'ia përcjellim komisionit përgjegjës për të vazhduar me procedurën e tij parlamentare sipas Rregullores së Kuvendit. Nëse do komisioni përgjegjës që të zhvillojë seanca dëgjimore më vete, është i lirë, e ka Rregullorja e Kuvendit. Unë kam kërkuar bashkëpunim që të mos i sjellim dy herë grupet e interesit në Kuvendin e Shqipërisë. Unë kam bërë gati kalendarin e komisionit tonë dhe do të vazhdoj me shqyrtimin e projektligjeve si komision për dhënie mendimi.

Taulant Balla - Zoti Kryetar, ia them miqësisht kryetares së Komisionit për Medien, se ne kemi pranuar të bëjmë një shkelje të një rregulli tash sa vite në Kuvendin e Shqipërisë, që kryetarët e komisioneve duhet të kenë të paktën një mandat deputeti me qëllim që të kenë eksperiencën e duhur për të drejtuar komisionin. Në kushtet e reja të krijuara, pa dyshim që ky rregull është shkelur me dashamirësinë e të gjithëve. Ky Kuvend sikurse çdo Kuvend në botë ka rregulla të parashikuara në Rregullore, ka dhe rregulla kutumjare, të cilat funksionojnë mbi bazën e traditës. Në vendin tuaj ka qenë Edmond Spaho apo kolegë të tjerë dhe kjo çështje nuk ka pasur kurrë diskutim. Ky është efektivitet parlamentar. Në Parlamentin Europian kur diskutohet buxheti prej 1,3 trilionë eurosh Komiteti për Politikën e Jashtme mbledhet bashkë me Komitetin për Çështjet e të Drejtave të Njeriut për të diskutuar komisionerin në fjalë.

U bëj thirrje shërbimeve të Kuvendit që në drejtimin e mbledhjes në pozicion e kryetarit të vendosin dy karrige: edhe karrigen e Ulsiut, edhe karrigen tuaj, por ju lutem duhet të ruajmë qetësinë në komunikimin me njëri-tjetrin dhe traditën që e kemi të konsoliduar tash sa vite. Rregullat e Kuvendit nuk ndryshojnë se keni ardhur ju në krye të atij komisioni. Rregullat e këtij Kuvendi edhe kur debati politik ka qenë tepër i madh kanë funksionuar, sepse për mua është e rëndësishme që publiku të ketë mundësinë të na dëgjojë. Nëse mbledhja bëhet e zgjeruar një prej sallave që përzgjidhet për t'u bërë është edhe kjo sallë, pavarësisht se do ta ketë Komisioni i Ekonomisë ekskluzivitetin për ta përdorur dhe pa dyshim që është Komisioni për Ekonominë ai që merr të gjithë vëmendjen publike gjatë këtij

debati. Kuvendi i Shqipërisë nën drejtimin, të paktën të Gramoz Ruçit nuk ka bërë ndonjëherë diskutim të shkurtuar, përkundrazi ky është buxheti i tretë që diskutojmë. Edhe sot po të shikoni jemi në datën 8 nëntor buxheti përfundon më 19 dhjetor, 42 ditë, ka kohë boll. Lërimi dënglat dhe uluni punoni si kryetarë komisionesh që t'i japim mundësinë publikut që t'i dëgjojë të gjithë deputetët!

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Po, zoti Roshi.

Enver Roshi – Kjo për të ndarë një eksperiencë bashkëpunimi midis dy komisioneve, është normale. Ne kishim ligjin “Për fortifikimin e kripës së jodizuar”, patëm kërkesë nga Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, nga zoti Peleshi dhe të dyja komisionet u mblodhën, debatet ishin në kufijtë e normales, ndoshta kaloi edhe normalja, por gjithsesi për mua është produktive kur këto mendime diskutohen, debatohen. Pastaj konkluzionet janë në komisionet përkatëse.

Gramoz Ruçi – Ka diskutime të tjera?

Adriatik Alimadhi - Faleminderit!

Këto eksperiencat e bashkëpunimit janë shumë të mira dhe unë i konsideroj shumë të dobishme, por për shkak të bisedës që lindi mendoj se duke pasur një kërkesë Komisioni i Arsimit, në këtë rast nga Komisioni i Ligjeve, ai të mblidhet dhe të vendosë. Komisioni me kërkesën e Komisionit të Ligjeve ta shqyrtojë, po ose jo. Pastaj ne të marrim një përgjigje se sa të merremi me debate.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë flas si procedurë, sepse procedura e zgjidh këtë punë.

Gramoz Ruçi - Ka ndonjë gjë tjetër? Nuk ka gjë tjetër për kalendarin. Për 4 çështjet që u trajtuan këtu, propozimi i zotit Ahmetaj, konsiderohet, të hiqet nga kalendari dhe të kalojë në program dhe të parashikohet kur të jetë gati qeveria.

Propozimi i zotit Manja dhe i zonjës Hajdari: 3 projektligjet në fjalë që u trajtuan nga zoti Manja dhe zonja Hajdari të kalojnë për dhënie mendimi edhe të Komisioni i Ligjeve, edhe të Komisioni për Integrimin.

Lidhur me amnistinë, nuk kemi nismë të kësaj natyre.

Elisa Spiropali - Prej më shumë se një muaji është ngritur një grup pune në Ministrinë e Drejtësisë nën drejtimin e ministres për të sjellë në qeveri dhe më pas në Kuvend një nismë për amnistinë, kryesisht për gratë e burgosura. Ka padrejtësi sistematike në të gjithë strukturën e sistemit të drejtësisë, në raport me gratë e dënuara dhe me radhë. Do të adresohet dhe shumë shpejt do të vijë brenda vitit me propozim të Kryeministrit një nismë për amnistinë.

Gramoz Ruçi - Zonja Ministre, mos më thoni ato që keni ndër mend. Unë këtu jam në institucion, nuk ka nismë për amnistinë.

Elisa Spiropali - Nuk ka të depozituar ende, por po flas...

Gramoz Ruçi - Më fal!

Se çfarë keni ndër mend, mbajeni ndër mend, atë që keni ndërmend kthejeni në letra, në nisma dhe silleni këtu.

Elisa Spiropali - Thashë vetëm për afatet, pra që do të vijë brenda vitit.

Gramoz Ruçi - Mirë, kur të vijë, atëherë edhe ne do të mblidhemi dhe do të bëjmë kalendarin.

Elisa Spiropali - Meqenëse kishte ndjeshmëri zonja Hajdari thashë ta adresoj si çështje.

Gramoz Ruçi - Zonja Hajdari ka ndjeshmëri, mirë bën që e ka ndjeshmërinë dhe ju ta keni ndjeshmërinë. Ndjeshmërinë të mos e keni vetëm për gratë, diskriminime nuk ka për çështje të tilla, as për gratë, as për burrat. Unë i kam dëgjuar këto diskutime. Të gjitha gratë dalin jashtë.

Elisa Spiropali - Me gjithë respektin 98% e vrasësve të grave janë burra, pra nuk besoj se ka vend për ndjeshmëri të madhe në këtë rast, ndërkohë që shumica e atyre që dënohen janë ato që vetëmbrohen. Prandaj lind nevoja për ta adresuar këtë padrejtësi.

Gamoz Ruçi – Kur të mbroni nismën, jepini të gjitha këto argumente, sot nuk ka nismë. Je përfaqësuese e qeverisë, por nuk ka nismë. Sillni nismën!

Elisa Spiropali - Nuk është depozituar, por do të vijë në Kuvend shumë shpejt.

Gramoz Ruçi - Për debatin që ngjalli zonja Dhimitri ju lutem shumë edhe një herë, pavarësisht se ka komisione që drejtohen nga pozita, ka komisione që drejtohen nga opozita, kur merret detyra qoftë ajo e Kryetarit të parlamentit, qoftë e drejtuesit të komisionit, përkatësitë partiake lihen mënjanë. Ta kemi të qartë këtë gjë. Secili nga ne duhet të jetë komplementar, nuk duhet të jetë i ndarë: kush je ti apo unë. Nëse është në interes të punës që grupet e interesit duhet të dëgjohen duhet të dëgjohen me seriozitet.

Nga ana tjetër kur themi të jemi komplementarë as grupet e interesit nuk duhet t'i vërdallosim nga një komision në tjetrin, madje tani që kemi projektbuxhetin edhe ministrat duhet të paraqiten në komisione, a ka mundësi që dy komisione bashkë ta dëgjojnë ministrin përkatës në një mbledhje të përbashkët, për shembull ministrin e Financave, edhe Komisioni për Ekonominë dhe Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese? Kur bëjmë kalendarin kryetarët e komisioneve të rakordojnë me njëri-tjetrin, jo vetëm kryetarët e komisioneve, por i gjithë komisioni, sepse këtu përfaqësojnë komisionin. Unë këtu vërtet jam Kryetar i Kuvendit, përfaqësoj parlamentin, por nuk kam të drejtë që jashtë vendimeve që merr parlamenti të kem

një mendim ndryshe, ashtu sikurse edhe ju kryetarët e komisioneve jeni vërtet kryetarët e komisioneve, drejtoni komisionin, por përfaqësoni vendimmarrjen e komisionit dhe jo vendimmarrjen tuaj.

Duhet të keni parasysh edhe një gjë, vërtet anëtarë të komisionit fjala vjen janë 13 apo 15, por ka një rregull në Rregulloren e Kuvendit, që askush nuk ia privon dot të drejtën asnjë deputeti nga 123 deputetë që të vijë në mbledhjen e komisionit tuaj, pasi ka për shembull interes të dëgjojë grupet e interesit X, ti nuk i thua dot: “Dil përjashta!”. Ashtu sikurse ti ke të drejtë të shkosh në mbledhjen e komisionit tjetër. Prandaj t’i kemi parasysh këto gjëra.

E miratojmë me konsensus edhe kalendarin.

Tani kam një çështje të fundit para se ta mbyll mbledhjen. Seanca e datës 14 nëntor, që e kishim në kalendarin e kaluar do të zhvillohet më datën 11 nëntor, ditën e hënë, jo të enjten për të respektuar afatin 30 ditor të shqyrtimit dhe të miratimit në seancë plenare të kandidaturave për anëtar të Gjykatës Kushtetuese. Do të kërkoja të gjithë vëmendjen e grupeve parlamentare, të gjithë deputetëve, pasi është një moment kurorëzimi i reformës dyvjeçare dhe më shumë që kemi bërë. Përfundimisht PD-ja ka sjellë kandidaturën përkatëse për sa i përket Kuvendit të Shqipërisë. Kemi një afat 30 ditor dhe seanca do të zhvendoset nga dita e enjte, ditën e hënë, që të respektojmë rigorozisht kërkesën e Kushtetutës. Kërkoj që të vlerësohet ky moment, pavarësisht nga përkatësitë. Anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, jemi të interesuar të gjithë që të plotësohen një ditë dhe më shpejt pasi kjo është vëmendja, interesi i të gjithë publikut shqiptar dhe i partnerëve tanë ndërkombëtarë që vëzhgojnë kurorëzimin me sukses të reformës në drejtësi. Dakord?

Taulant Balla - Në vijim të asaj që tha Kryetari i Kuvendit, pa dyshim, jemi dakord që seanca të zhvillohet ditën e hënë. Do të ishte mirë që edhe procesi i votimit të anëtarëve të rinj të Gjykatës Kushtetuese (duke u mirëkuptuar me të gjithë kryetarët e grupeve të kishim një numër të caktuar folësish për çështjet e tjera. Është një marrëveshje, me sa di unë për aderimin e Shqipërisë në një konventë për Mesdheun, që besoj se nuk ka kundër për të hyrë edhe ne në atë konventë) që të planifikohej në funksion të folësve dhe të bëhet në orën 12:00, pra të jetë e përcaktuar me qëllim që të garantohet pjesëmarrja e të gjithë deputetëve.

Unë në emër të Grupit Parlamentar të PS-së deklaroj se do të marrim masat të jemi të gjithë, sikurse është votuar reforma në drejtësi me 140 vota, edhe pjesëmarrja për anëtarët e rinj të Gjykatës Kushtetuese të jetë në nivelin maksimal 100% të deputetëve prezent në Kuvendin e Shqipërisë.

Nimet Musaj - Faleminderit, zoti Kryetar!

U bënë 8 muaj që tashmë jemi këtu dhe për ne është një moment shumë i rëndësishëm që po japim kontributin tonë për reformat madhore, siç është rasti i votimit të ditës së hënë.

Patjetër bashkë me të gjithë kolegët e grupit, mendoj të jemi në unison për t'i votuar kandidaturat.

Gramoz Ruçi – Mirë, atëherë, nuk ka gjë tjetër.

Ditën e hënë do të jetë seanca plenare në orën 10:00. Faleminderit.

E mbyllim mbledhjen.

MBLEDHJA MBYLLET